

**BAHTIJAR KRYEZIU, FJALOR ONOMASTIK I MALËSISË SË
BUJANOVCIT, BOTIM I IAP-SË, PRISHTINË, 2006, 238 f.**

Prej kohësh në studimet albanologjike, të dhënat e onomastikës dhe hulumtimet e shqyrtimet e hapëta rreth emrave të viseve (*toponimeve*) dhe emrave të njerëzve (*patronimeve dhe antroponimeve*) kanë përbërë një mëtim të lakmueshëm për studiuesit më në zë. Madje, nuk mund të mos themi se, në hapat e parë të shpjegimeve historike për gjuhën shqipe dhe fazat e hershme të zhvillimit të saj, kanë qenë pikërisht emrat e viseve dhe përgjithësisht emrat e përmendur nëpër mbishkrime, pastaj edhe në shkrime e dokumente të ndryshme, që kanë pasur rolin e dëshmuesve të pranisë së shqipes e të shqiptarëve në trojet e tyre të sotme. Mjafton të përmendim se shumë nga shpjegimet serioze rreth historisë së gjuhës shqipe e, madje, edhe për historinë e popullit shqiptar si vijues i ilirëve, janë shestuar, zhदारitur e mbështetur pikërisht me të dhënat e onomastikës iliro-shqiptare.

Hullitë e mbara të mjeshtrove të albanologjisë, prof. E. Çabejt në Tiranë dhe e prof. I. Ajetit në Prishtinë, për fat të mirë po ndiqen nga një numër i mirë studiuesish shqiptarë këtej- e përtej kufijve të RSH-së.

Dhjetëvjeçari i fundit i shekullit që lamë pas, si dhe vitet e para të mijëvjeçarit të ri, për fat të mirë, tregojnë se edhe fusha e onomastikës shqiptare, ndërsa kishte mbetur gati krejt në fazën nistore, më fort në punë grumbulluese e sistematizuese, gjithsesi kryesisht përnjohëse, ka filluar të marrë hapësira të reja. Kanë qenë të mirëseardhura këto vitet e fundit një numër i mirë studimesh monografike, kryesisht disertacione për gradën e doktorit të shkencave filologjike, me anën e të cilave është pothuajse duke u plotësuar një areale e hapët, ndoshta edhe gati shteruese, e hetimeve dhe përshkrimeve dialektologjike dhe onomastike të trevave shqiptare në Kosovë e në Maqedoni. Shohim me kënaqësi se gjithandej në kuadër të studimeve pasuniversitare, si për shkallën e parë, po sidomos në ato të shkallës së dytë, ka pasur qasje të mira ndaj kësaj dege të gjuhësisë. Kemi parasysh, ndër të tjera, botime të rëndësishme si: “*Vështrime gjuhësore rreth disa toponimeve të Plavës dhe të Gucisë*” (Mehmet Ahmetaj), “*Mikrotoponimia në fshatrat Obri dhe Tërdevc të Drenicës*” (Xhemal Bajrami), “*Toponimet e Llapushës (Prekorupës)*” (R.Doçi), “*Toponimia e fshatit Jabllanicë*” (Hasan Hasani), “*Kontribut për studimin e toponimisë së Dushkajës*” I dhe II (Skënder Hoxha), “*Toponimia e fshatit Tërpezë*” (Sali Krasniqi), “*Toponimia e fshatit Malishevë*” (Sali Krasniqi), “*Toponimia e Malësisë së Tetovës*”

(Fadil Sylejmani), si dhe një tufë vështrimesh rreth mikrotoponimisë së katundeve Obri dhe Tërdevc të Drenicës, Glllogovicë, Bukovik e Capar (Begazad Baliu) etj.

Në vargun e këtyre punimeve hyjnë edhe kërkimet në terren, studimet dhe shqyrtimet tashmë sistematike të studiuesit Bahtjar Kryeziut, kushtuar onomastikës së Hashanisë, studim me të cilin ai, vite më parë, mbrojti dhe fitoi gradën “Doktor i shkencave gjuhësore” dhe, tashti së mbrami, libri “*Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit*”, botim i IAP-së, Prishtinë 2006.

Prej këtij studiuesi, ndërkaq, qysh më parë, në faqet e revistës shkencore “Gjurmime albanologjike” kishim pasur edhe një ndihmesë interesante kushtuar mikrotoponimisë së fshatit Rogaçicë”¹.

Në vijim, i prekur tashmë nga “virusi” i kërkimit shkencor, dr. Kryeziu, pas marrjes së titullit shkencor, iu përkushtua edhe më me zell, do të thoshim me vrull të ri, mbledhjes sa më tërësore, shqyrtimit e krahasimit të lëndës onomastike dhe, duke gjetur edhe hapësira të atilla, gati djerre, na dha para pak kohësh edhe një libër tjetër, sipas meje shumë të vlefshëm e të pasur me lëndë e shtjellime onomastike, siç është “*Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit*”.

Recensuesit akad. I. Ajeti, prof. Q. Murati dhe dr. B. Baliu, të cilët, ndërsa e rekomandonin për botim këtë libër të ri të B. Kryeziut, kanë vënë në dukje me të drejtë se ky fjalor me lëndën e tij shumështrësore pa dyshim përbën ndihmesë të çmuar në lëmin e kërkimeve gjuhësore e kulturore-historike, si për trajtimin shkencor që autori i bën kësaj lënde, ashtu dhe për faktin se vë në dukje e sjell një korpus të përfillshëm emërvendesh nga Malësia e Bujanovcit.

Librin e B. Kryeziut “*Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit*” kryekreje dëshiroj ta cilësoj si fryt i një pune të gjatë e të kujdesshme mbledhëse, sistematizuese dhe shkencorizuese. Për këtë cilësi, ndonëse libri nden edhe vlera të tjera të rëndësishme, ne do ta quajmë si burim me vlerë të dhënash e emërvendesh shqiptare prej një treve anësore, por edhe pjellore nga pikëpamja e leksematikës dhe e emërvendëve që përmban.

Qysh herët, sikundër dihet, asaj treve i pat kushtuar rreshta dorëmbarë edhe vetë akad. Idriz Ajeti, i cili në studimin “*Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të Preshevës dhe të Bujanovcit*” na ka dhënë njohuritë më të para rreth tipareve dhe dukurive e vendit të asaj

¹ Shih: B. Kryeziu, *Mikrotoponimia e fshatit Rogaçicë*, në “Gjurmime albanologjike” SSHF, XVIII, Prishtinë, 1984.

së folmeje në kuadrin e ligjërimeve shqiptare të Kosovës dhe më gjerë, duke gjetur edhe vendin e tyre në ndarjen dialektore të sotme të gjuhës shqipe.² Hullinë e mbarë të mjeshtrit të madh I. Ajetit, në të njëjtat hapësira të Bujanovcit, por në drejtimin kryesisht të onomastikës e vijon me përkushtim të dukshëm studiuesi Bahtijar Kryeziu në *“Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit”*. Ky fjalor vjen në vështrim si ndihmesë e vyer edhe për rrethanën se fjalorët onomastikë në gjuhën shqipe janë të paktë. Në kohën tonë, kur dialektet dhe pasuritë e tjera gojore të popullit, siç shprehej me drojë të dukshme Eqrem Çabej *“po shkojnë drejt tretjes si kripa në ujë”*, edhe emërvendet dhe përgjithësisht lënda onomastike nga krahinat është jo vetëm e vlefshme, por edhe e atillë që kërkon ta mbledhim, ta studiojmë dhe ta botojmë sa më parë. Nuk mund të mos përsërisim më këtë rast se toponimia dhe emrat e njerëzve janë me shumë interes, jo vetëm për gjuhësinë, por edhe për disiplina të tjera, si për gjeografinë, gjeologjinë, arkeologjinë, historinë, etnografinë, folklorin etj.

Meritë e shenueshme e Fjalorit të B. Kryeziut është se aty, përveç emërvendëve dhe topoleksemave të mirëfillta, janë shënuar edhe emrat e familjeve, të lagjeve, vëllazërive e të fiseve të asaj treve, shpesh duke qëmtuar e cituar edhe dukjen e tyre në disa dokumente të hershme. Krejt lënda, kur ka qenë e mundur, është kundruar edhe në aspektin historik dhe janë bërë edhe sprova të lëvdueshme për shpjegimin e gurrës së mjaft prej toporrënjëve që përmbahen në të.

Së mbrami, natyrisht, theksojmë se *“Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit”* është i mirëseardhur edhe për rrethanën se lënda e tij vjen prej një hapësire etnike shqiptare, e cila, duke qenë jo vetëm në anët e mënjanuara, po edhe nën tryshinë e paprerë të ndikimeve serbe, ka rrezik të pësojë fatin e krahinave të Sanxhakut të Nishit, që, sikundër përmend me ankth autori, *“në vitet 1875-1878, shqiptarët qenë lënë në mëshirën e të pamëshirëve”*.

Por, kryesorja është se kjo zonë, siç e thekson vetë autori në hyrjen e Fjalorit, ka onomastikë të pasur dhe mjaft të larmishme. Edhe pse aty, si shumëkund gjetkë në anët e trevave verilindore të shqipes, ka edhe prani të elementeve alogjene: turke, sllave, greke, vllehe etj., prapëseprapë mbizotëron elementi shqiptar, si dëshmi e pranisë së hershme të shqiptarëve në këto hapësira, qysh nga lashtësia e deri në ditët

² Shih: I. Ajeti, *Rreth disa veçorive të të folmeve të shqiptarëve të Preshevës dhe të Bujanovcit*, “Kërkime gjuhësore”, Prishtinë, 1978.

tona; këtë e dëshmon mjaft gjerë edhe onomastika, sidomos emërvendet mjaft të moçme që janë grumbulluar me aq kujdes nga B. Kryeziu.

Me vështrim objektiv, të arsyetuar dhe të mbështetur mirë nga ana historike e gjeopolitike, në Fjalor është trajtuar edhe ndikimi e huazimi prej gjuhëve të mjedisit rrethues, sidomos ai fond topoleksemeash që, në fakt, janë shqiptare, por të formuara mbi bazën e huazimeve leksikore prej sllavishtes. Me të drejtë autori shënon se, ndërsa *“dukuria e ndikimeve sllave, turke, arumune e të tjera ka qenë mjaft e përhapur, procesi i kundërt, i shqiptarizimit të elementit sllav, nuk ka pasur mundësi të ndodhë në mungësë të konstituimit të bashkësisë shqiptare si bashkësi politike, shtetërore, administrative e fetare në të kaluarën. Përhapja e toponimeve dhe e patronimeve, në radhë të parë sllave e turke ndër shqiptarë, kishte ndodhur, siç dihet, me ndërhyrje shtetërore, administrative e kishtare, me rastin e regjistrimeve të ndryshme të popullsisë e të tokave të tyre për shkaqe tashmë të njohura”* (f.6).

Në librin *“Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit”* studiuesi B. Kryeziu ka pasur synim të nxjerrë në pah gjithë materialin onomastik të krahinës në fjalë dhe këtë ai e ka përmbushur me punën e tij të zellshme, me hulumtime shumëvjeçare dhe të kujdesshme, si dhe duke iu përmbajtur kërkesave metodologjike për kërkimet në fushën e onomastikës. Gjithashtu, ai ka lakmuar dhe ia ka dalë në krye me sukses të bëjë edhe shtresëzimin e atij materiali, duke gërshetuar përshkrimin e qasjen sinkronike me hetimin e tëhollimet diakronike. Për këtë atij i kanë vlejtur edhe një numër hartash, regjistrash, defterësh, si dhe një literaturë mjaft e pasur në gjuhën shqipe, sllave dhe në mjaft raste edhe osmane-turke.

Fjalori, si çdo vepër e tillë, i parë në tërësi, afron, ngjason dhe përkon në shumë pika me lëndën e njohur nga mbledhjet, botimet dhe studimet e tjera rreth toponimeve dhe patronimeve të gegërishtes, madje edhe të mbarë shqipes.

Lënda e fjalorit është renditur alfabetikisht dhe, jo rrallë, zërat janë trajtuar e shtjelluar gjerë, me mëtime e shtjellime të hapëta, plot përqasje, krahasime dhe, sa herë e shihet të mundshme, edhe me ndonjë shpjegim rreth etimologjisë. Njohja e mirë e literaturës teorike i ka shërbyer autorit edhe për të ndërmarrë shqyrtime të hapëta e për të arsyetuar në mënyrë të mbështetur.

Po të kundrohet në bazë të shqyrtimeve të mbështetura në kritere tematike dhe të treguesve me vlerë etnolinguistike, si dhe duke e

kundruar në krejt atë që ndejnë prurjet dhe shpallimet e tij, mund të përthekohet një vlerësim pozitiv, i nyjëtuar në cilësimet që vijojnë:

1) Gjithandej shquajnë emërtime shqiptare, me lëndë shqipe, ndonjëherë edhe mbi huazime të moçme (*vada, reka, bunari, zabeli*), por të atilla ku, megjithatë, shquan shqiptarësia strukturore dhe semantike.

Aty, shumë nga mikrotoponimet përmbajnë fjalë nga leksiku i shqipes tashmë të njohura si toporrënjë për klasat më të gjera të mikrotoponimisë shqiptare, si: ara, balli a ballnat, beshka (bjeshka), bira, bria (brinja), qafa, qarri, çurshia (qershia), dardha, dardhishta, firishta (fierishta), funi (fundi), fusha, gropa e gropishta, kroi, shkoza, kulla, lama (lëmi), lethia (lajthia), livadhi, lugaja a lugata, dafina, rrahi (rrahu), thiu (derri), mali, mullini (mulliri), prroi (përroi), rrafshi, shpella, dhevi (dheu), hurdha.

2) Me interes e vlerë janë, gjithashtu, topnimet që ndjekin ndërlihdërinë e çiftëzuar sipas kuptimeve antonimike, ku shquajnë sidomos: *i madh-i vogël, i epërm-i poshtëm, i gjatë- i shkurtër* dhe mbiemra që tregojnë ngjyrë a cilësi të përhershme dhe të dukshme, si: *i keq, i kuq, i zi, i ndërmjetëm* etj., si: Capari Madh-Capari Vogël, Kroi Madh; Lugata Madhe-Lugata Vol (vogël), Lugi Madh; Gerlica Madhe-Gerlica Vogël; Dullani Epër, Kolishta Epër-Kolishta Poshtëm, Kroi Epër, Dullani Poshtëm, Fusha Epër, Xhardaçishta Epër- Xhardaçishta Poshtëm; Fusha Gat, Livadhi Gat, Fusha Madhe, Fusha Vo(ge)l, Kodra Madhe, Guri Bardh, Guri Zi, Guri Keç, Gurt e Kçi, Kroi Keç, Prroi Keç, Killat e Kçia, Te Dhevi Kuç etj.

3) Në Fjalor ka edhe disa toponime që, ndonëse të rralla, janë të mirëseardhura e të çmueshme në lëmin e studimeve dhe shpjegimeve të përgjithshme rreth onomastikës dhe më gjerë në kuadrin e shqyrtimeve etnolinguistike. Kemi parasysh, ndër të tjera, ndonjë nga toponimet me bazë mitologjike si *Vorret e Shtrigave* ose, sidoqoftë, të ngritura mbi bazën e një mendësie tipike shqiptare e të moçme, si: *Guri Babes Plak, Kalanica Babes Plak, Lisi Dades Fat*.

4) Me interes të madh janë, gjithashtu, prurjet që sjellin toporrënjë të bujqësisë e të bimësisë së kultivuar, apo sikundër e kemi quajtur ndryshe reth onomastikës agrare, si fusha ku edhe ky Fjalor ka prurje me vlerë e që, me siguri, do të na vlejnë për tëhollimet teorike lidhur me vendin e peshën e bujqësisë në jetën e mendësinë e shqiptarëve. Me interes është, gjithashtu, zoonimia ose leksematika që ndejnë shumë toponime që përmbajnë fjalë si *arusha, sokoli* (skifteri), *uki* (ujku), *thivi* (thiu i egër, derri) etj.

Shprehim bindjen se “*Fjalor onomastik i Malësisë së Bujanovcit*” përbën një punë të vyer, të kujdesshme dhe me rëndësi për onomastikën shqiptare, ajo dëshmon për ecurinë rritëse e pjekurinë e plotë shkencore të autorit, po edhe një tregues të gëzueshëm të kaheve të reja, gjithmonë e më të epërme që po marrin studimet shkencore në Kosovë.

Gjovalin SHKURTAJ